

VENDIM
Nr.878, datë 22.12.2004

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I AKSIT RRUGOR
“RRAPI-SHKOLLA “TH.TANI”- KRYQËZIM SPITAL”, NË QYTETIN E BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga zgjerimi i aksit rrugor “Rrapi-shkolla “Th.Tani” – kryqëzim spital”, në qytetin e Beratit.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Beratit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 198 m² tokë truall, e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 663 300 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri “Investime”, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 175 500 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë dhe të përballohet nga bashkia e Beratit.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në muajin dhjetor 2004.
 7. Punimet të realizohen deri në muajin mars të vitit 2005.
 8. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe bashkia e Beratit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA ZGJERIMI I AKSIT RRUGOR
“RRAPI-SHKOLLA TH.TANI-KRYQËZIM SPITAL” NË QYTETIN E BERATIT**

Nr.	Emri mbiemri	Sip.toke are/m ²	Njësia lekë/m ²	Vlera/lekë
1	Ali Jonuz Kora	198	3350	663 300
2	Dilavin Jonuz Kora			
3	Muharrem Jonuz Kora			
4	Nazif Jonuz Kora			
5	Gjylzemin Jonuz Kora			
	Totali			663 300